

Helsinki

# Informacione prindërve për mësimin e finlandishtes si gjuhë të dytë (S2) -në shkollën fillore



# Përbërja

Hyrje 3

Mësim që mbështet zhvillimin gjuhësor ..... 3

Finlandishte si gjuhë e dytë dhe letërsi -zgjedhja  
e kurrikulës ..... 4

Mësimi, përcjellja e aftësisë gjuhësore dhe ndryshimi  
i kurrikulës ..... 5

S2-kurrikula në planprogramin mësimor ..... 6

Mënyrat e zbatimit të S2-mësimit ..... 6

Shumëgjuhësia në shkollë ..... 7

Roli i prindit në mbështetjen e aftësisë gjuhësore ..... 8

Mirëmbajtja e gjuhës së vete ..... 8

## Hyrje

Ky udhëzues ofron informacione për mësimin e finlandishtes si gjuhë të dytë në shkollat fillore prindërve të nxënësve të Helsinkit.

Në te gjinden përgjigjet në mes tjerash në pyetjet si vijon:

- Çfarë don të thotë mësimi i finlandishtes si gjuhë të dytë?
- Mbi çfarë baze nxënësit i preferohet pjesëmarrja në S2-mësimin?
- Si është i organizuar S2-mësimi në shkolla?
- Si mundën prindërit ta mbështesin zhvillimin gjuhësor të fëmijës?

Praktikat dhe informacionet e njejta vlejné edhe për mësimin e suedishtes si gjuhë e dytë në shkollat e Helsinkit, dallimi është që gjuha e S2\_mësimi është suedishtja.

## Mësim që mbështet zhvillimin gjuhësor

Në shkollat fillore të gjuhës finlandishte dhe suedishte të Helsinkit ofrohet mësim që merr parasyshë veçanërisht nevojat e nxënësve të huaj dhe shumëgjuhës për mësim. Ky lloj mësimi për shembull është mësimi pregaditor, mësimi i gjuhës amëtare dhe mësimi i finlandishtes si gjuhë e dytë, në të cilat gjëra veçanërisht përqëndrohet ky doracak udhëzues. Poashtu, në mësimin e nxënësve të ndryshëm, mësimi i gjuhës zhvillohet për shembull duke zgjëruar vokabularin e fjalëve dhe duke ushtruar aftësitë e ndryshme me tekste.

### Mësimi pregaditor

Në mësim pregaditor dërgohen fëmijët te të cilët aftësitë e finlandishtes/suedishtes janë në nivelin fillestar të gjuhës (A1). Në këtë mësim dërgohen fëmijët që po sa kanë arrijtur në Finlandë dhe sipas nevojës fëmijët e lindur në Finlandë në bazë të aftësisë gjuhësore. Gjërësia e mësimiit pregaditor i përgjigjet kurrikulas mësimore të një viti shkollor. Gjatë kësaj kohe mësojnë gjuhë finlandishte dhe shkathtësitë tjera të vijimit të shkollës. Nëse është i gatshëm, xënësi mund të kalon në mësim parashkollor ose në mësim fillor edhe para se të kalon viti.

### Mësimi i gjuhës së vete amëtare

Mësimi i gjuhës së vete amëtare është mësim plotësues që mund ta merr nxënësi që ka gjuhë amëtare tjetër nga finlandishtja ose suedishtja. Synimi i mësimdhënies në gjuhën e vete amëtare është ta përforcon gjuhën e vete amëtare që të mund të mëson në atë gjuhë dhe të ta përdorë në mënyrë të gjithanshme. Mirë është që prindërit ta përdorë gjuhën e tyre të fortë amëtare dhe ta inkurajojnë dhe mbështesin fëmijën ti mëson gjuhët tjera.

### S2-mësimdhënia

Kurrikula e finlandishtes si gjuhë e dytë dhe letërsi është e njejtë me kurrikulën e gjuhës amëtare me letërsi. Aty dërgohen fëmijët te të cilat finlandishtja është zhvilluar por akoma nuk mjafton që nxënësi ta mëson finlandishten si gjuhë amëtare. S2-mësimdhënia zhvillon gjuhën finlandishte te nxënësi ashtu që ai të mund të vepron dhe të mëson në mënyrë të barabartë me tjerët. S2-mësimdhënia inkurajon që të shfrytëzohen edhe gjuhët tjera që flasin nxënësit në mësimin e finlandishtes dhe lëndëve tjera shkollore.

Në vazhdim keni informacione më të sakta për kurrikulën e finlandishtes si gjuhë e dytë dhe letërsi dhe për shumëgjuhësinë në shkollë.

## Finlandishte si gjuhë e dytë dhe letërsi -zgjedhja e kurrikulës

Gjuhë amëtare dhe letërsi është lëndë e përbashkët për të gjithë nxënësit. Lëndët shkollore kanë kurrikulë të ndryshme. Një nga to është gjuhë dhe letërsi finlandishte (S1) dhe tjetra finlandishte si gjuhë e dytë dhe letërsi (S2). Në Helsinki mësohet edhe kurrikula gjuhë e shenjave dhe letërsi. Nxënësi zakonisht mëson kurrikulën S1- apo S2.

### Kujt i është dedikuar S2?

Kurrikula finlandishte si gjuhë e dytë dhe letërsi (S2) i është dedikuar nxënësit:

- 1) gjuha amëtare e të cilit është tjetër nga finlandishtja, suedishtja ose saame apo i cili ka prejardhje shumëgjuhësore dhe
- 2) aftësia e të cilit në finlandishte nuk mjafton për ta mësuar kurrikulën gjuhë dhe letërsi finlandishte apo
- 3) në aftësitë gjuhësore e të cilit ka mungesa të qarta në disa nën-zona (nën-zonat janë të kuptuarit e gjuhës së folur, të folurit, të shkruarit dhe të kuptuarit e tekstit).

Mësueset që japin mësim nxënësve bëjnë së bashku vendimin se a i preferojnë nxënësit kurrikulën gjuha finlandishte si gjuhë e dytë. Sidoqoftë, prindi vendos për kurrikulën.

## Çka ndikon në preferencën dhe përzgjedhjen për S2-mësimdhënien?

Në përzgjedhjen e kurrikulës ndikon vetëm aftësia e nxënësit në gjuhën finlandishte në raport me aftësinë në finlandishte që nevojitet për vijimin e shkollës sipas moshës së tij. Në përzgjedhjen e kurrikulës nuk ndikon pjesëmarrja në mësim të gjuhës së vete amëtare ose çfarë është shënuar si gjuhë amëtare në sistemin e informacioneve për popullatën. Edhe nëse si gjuhë amëtare e nxënësit është shënuar finlandishtja, nxënësit mund ti preferohet S2-kurrikula nëse ka mangësi në aftësi gjuhësore. Mund ti preferihet S1-kurrikula në bazë të aftësisë gjuhësore të mjaftueshme edhe nëse si gjuhë amëtare i është shënuar gjuhë tjetër e jo finlandishtja.

Disa shembuj për rastet kur zakonisht nxënësit i preferohet S2-kurrikula:

- Nxënësi nuk mund të komunikojë rrjedhshëm në finlandishte në situatat ditore në shkollë
- Nxënësi ka vështësi të përcjell mësimin në lëndë të ndryshme shkollore dhe të merr pjesë në veprimet shkollore në finlandishte
- Nxënësi flet finlandisht në situata ditore rrjedhshëm, por aftësia e tij gjuhësore akoma nuk mjafton që ta kuptojë tekstin e lëndëve të ndryshme shkollore ose të prodhoni tekst
- Nxënësi nuk lexon dhe/ose nuk shkruan akoma në nivel të moshës së tij aq mirë sa të mund të mëson pavarësisht dhe të merr pjesë në veprimet shkollore.

## Nxënësi flet rrjedhshëm finlandishten, pse pra i preferohet S2-mësimi?

Përgjegjja shpesh gjindet në dallimin në mes të aftësisë shkollore komunikative dhe akademike. Folësi përdorë aftësi gjuhësore komunikative në ndikim reciprok ditor kur folësi zakonisht bisedon për gjëra konkrete dhe përdorë fjali më të thjeshta. Aftësinë gjuhësore komunikative mund ta përvehtëson brënda dy viteve.

Sa më shumë që zgjatë vijimi i shkollës aq më tepër do të ketë nevojë që të zotron gjuhë më kërkuese të lëndëve shkollore dhe të menaxhon situata të ndryshme të përdorimit të gjuhës. Në klasët më të larta nevojitet gjuhë që përbën shumë shprehje abstrakte, shkathësi teksti dhe koncepte të lëndëve shkollore me lloje të ndryshme të teksteve. Arritja e aftësisë gjuhësore akademike zakonisht zgjatë nga pesë deri shtatë vite.

## Prindi vendos për përzgjedhjen e kurrikulës në bazë të informacioneve të dhëna

Prindi dhe mësuesja marrin pjesë në përzgjedhjen e kurrikulës të lëndës shkollore gjuhë amëtare dhe letërsi (S2 ose S1). Mësueset përcaktojnë kurrikulën që më së miri mbështet të mësuarit të nxënësit dhe atë ia preferojnë prindërve. Sidoqoftë, prindi vendos për kurrikulën. Bazë për përcaktimin e kurrikulës janë aftësitë gjuhësore të nxënësit dhe kërkesat gjuhësore të grupit të moshës së tij për mësim. Dienia e nxënësit kontrollon në të gjitha nën-zonat e aftësisë gjuhësore.

Përzgjedhja e kurrikulës është afatgjate, por nëse aftësitë zhvillohen mjaftë S2-kurrikulën mund dhe duhet të ndryshohet në S1-kurrikulë. Atëherë duhet prap të kontrollohen aftësitë e nxënësit në nën-zona të ndryshme gjuhësore. Mësueset i tregojnë prindërve për synimet e S2-kurrikulës, si do të zbatohet mësimi dhe pse është në favor të nxënësit.

Mësimi i finlandishtes si gjuhë të dytë nuk është mësim mbështetës. Për mësim sipas S1 dhe S2 kurrikulës apo planit mësimor janë rezervuar numër i njejtë i orëve. Nxënësi që mëson me S2-kurrikulën si dhe S1-nxënësi mund të marrë mësim mbështetës në lëndë të ndryshme pas përfundimit të orëve të rregullta në shkollë, kur ka nevojë për atë. Me ndihmën e mësimit mbështetës mësuesja ndihmon nxënësin të arrijë synimet e kurrikulës.

## S2-kurrikula dhe shkollimi më pas

Në shkollimin profesional dhe në gjimnaz është poashtu e mundur të mësohet me finlandishten si gjuhë e dytë. Nëse aftësia gjuhësore e nxënësit akoma nuk mjafton për pjesëmarrje në shkollim profesional apo në gjimnaz, nxënësi mund të aplikon për shkollim pregaditor për shkollën të mesme (TUVA, nga vjeshta 2022), synim i të cilit është përfundimi i aftësisë gjuhësore dhe mësimore. Me përfundimin e planit mësimor të gjimnazit është e mundur të ipet provimi i maturës në finlandisht si gjuhë të dytë.

Në shkollat e larta Bordi i arsimit preferon që të barazohet trajtimi i mësimeve S2 dhe S1 për aplikuesit në shkollën e larta. Synohet që mos të bëhen dallime në atë se në cilën kurrikulë apo në cilin plan mësimor ka marrë pjesë nxënësi. Politika e shkollave të larta me dhënjën e pikëve ndryshon, andaj duhet ta përcjellni situatën aktuale, për shembull të këshilltari për studime.

## Mësimi, përcjellja e aftësisë gjuhësore dhe ndryshimi i kurrikulës

Me rëndësi është që informacionet për zhvillimin e aftësisë gjuhësore të nxënësit të përcjellen mësueseve të reja kur nxënësi fillon shkollën, ndryshon grupin/klasën, shkollën apo mësuesën. Kur mësuesja i merr informacionet për nivelin e aftësisë gjuhësore të nxënësit, për anët e forta dhe eventualisht për nevojat për ndihmë, ajo mund të planifikon mësimin për nxënësin. Është shumë me rëndësi që me transferimin e informacioneve të sigurohet vazhdimi i zhvillimit të aftësisë gjuhësore të nxënësit pa ndërprerje.

S2-mësuesja dhe mësuesja ose kujdestarja e klasës njohtohen me dokumentet e nxënësit, për shembull me vlerësimin e aftësisë gjuhësore të shkruar në planin mësimor apo sipas nevojës bëjnë testimin e aftësisë gjuhësore të nxënësit. Ato poashtu përcjellin zhvillimin e aftësisë gjuhësore të nxënësit gjatë shkollës fillore. Në bazë të zhvillimit të nën-zonave të aftësisë gjuhësore kontrollohet edhe përshtatshmëria e kurrikulës së gjuhës amëtare me letërsi (S1 ose S2) për nxënësin dhe ndryshohet sipas nevojës.

Nëse në bazë të të vërejturit mësueset vendosin të preferojnë ndryshimin e planit mësimor, bisedojnë për këtë me nxënësin dhe me prindin. Prindi nënshkruan/firmos formularin për ndryshimin e kurrikulës nëse pajtohet me ndryshimin e planit mësimor. Prindi mund të kërkon arsytim se pse fëmija i tij është preferuar për ndonjë plan mësimor. Prindi mund të kërkon që mësueset ta verifikojnë përshtatshmërinë e planit mësimor dhe të tregojnë mendimin e vet se a preferojnë ndryshim të planit mësimor apo kurrikulës.

Sidoqoftë, ndryshimi i planit mësimor është i mundur vetëm gjatë shkollës fillore para klasës së nëntë. Përzgjedhja e planit mësimor në pikënisje është afatgjate me qëllim të sigurohet vazhdueshmëria e zhvillimit të aftësisë gjuhësore. Nota/vlerësimi i lëndës gjuhë amëtare dhe letërsi bazohet në synimet e planit mësimor me të cilin ka mësuar fëmija.

Mësimi i nxënësit me S2-kurrikulën në shkollë mund të organizohet në mënyrë tjetër varësisht nga faza e zhvillimit të aftësisë gjuhësore dhe nevojës së tij për mbështetjen gjuhësore. Nxënësi që mëson me S2-kurrikulën për shembull mund të mëson më tepër ose më pak në grupin e njejtë me S1-nxënësit. Praktikata e shkollave në zbatimin e mësimit ndryshojnë. Më poshtë keni të përshkruar se në çfarë mënyra të ndryshme zakonisht zbatohet S2-mësimi.

## S2-kurrikula në planprogramin mësimor

Synimet e kurrikulës së lëndës finlandishte si gjuhë e dytë me letërsi në planprogramin mësimor pjesërisht janë të njejta ose në drejtim të njejtë me kurrikulën finlandishtja me letërsi. Nga nxënësit që mësojnë me S2-kurrikulën sidoqoftë nuk kërkohet që të kenë të gjitha aftësitë e njejta si S1-nxënësit.

Detyrë e veçantë e S2-kurrikulës është zhvillimi i aftësisë gjuhësore duke marrë parasyshë nivelin gjuhësor të nxënësit si dhe mbështetja e dënës dhe identitetit shumëgjuhësor. Synimi është të ndihmon nxënësin të arrijnë nivel të mjaftueshëm të aftësisë gjuhësore për mësimin e lëndëve të ndryshme shkollore dhe për shkollim të mëtutjeshëm (shkollim profesional, gjimnaz, shkollë e lartë). Mësimi jep nxënësve mjete për ta zhvilluar vazhdimisht aftësinë gjuhësore më vonë në jetë.

Në S2-mësimin përforcohet vetbesimi te nxënësi në këmbimin e mesazheve dhe ndihmohet që të vëren anët positive të veta dhe që të trimërohet ta përdorë gjuhën. Në S2-mësimin tekstet janë të zgjedhura sipas aftësisë gjuhësore të nxënësit. Në S2-orët sistematikisht zgjërohet vokabulari i fjalëve dhe bisedohet për rëndësinë e fjalëve dhe shprehjeve dhe dallimin mes tyre si dhe krahasojnë të shprehurit në gjuhët e ndryshme.

Tema të S2-mësimit për shembull janë tekstet e lëndëve dhe mediave të ndryshme, jeta personale, jeta shkollore dhe veprimi në shoqëri. Kështu zgjërohet përdorimi i gjuhës edhe jashtë shkollës. Nxënësin e mësojnë të shpreh mendimet dhe emocionet e veta në mënyrë që i përshtatet situatës si dhe të lexon tekste të ndryshme dhe libra.

## Mënyrat e zbatimit të S2-mësimit

S2-mësueset dhe mësueset tjera bashkëpunojnë në dhënjen e mësimit të planeve mësimore të ndryshme të lëndës gjuhë amëtare dhe letërsi. S2-mësimi zakonisht organizohet në kohë të njejtë me S1-mësimin, pra gjatë orëve të lëndës gjuhë amëtare dhe letërsi. Nxënësit e të dy planeve mësimore mund të mësojnë së bashku.

Nëse mësim jep një mësuese, ajo mendon për mësimin, materialin mësimor, detyrat dhe vlerësimin sipas synimeve të S2 dhe S1-planit mësimor dhe nivelit të aftësisë gjuhësore të nxënësve. Ndonjëherë dy mësuese, për shembull mësuesja e klasës dhe S2-mësuesja mund të dhëjnë mësim në të njejtën kohë në klasë. Atëherë S2-mësuesja merr më tepër përgjegjësi të mëson sipas S2-planit mësimor.

Vërtetë, qëllimi është që S2-mësuesja të mëson një pjesë të S2-mësimit në grup të veçantë ku mund ta fokuson dhënjen e mësimit në ato nën-zona të aftësisë gjuhësore në të cilat nxënësi ka nevojë. Pavarrësisht nga ajo se në cilin grup nxënësi ka marrë mësim sipas S2-planit mësimor, dënës dhe përparimi i tij notohet apo vlerësohet në raport me synimet e planprogramit mësimor të S2-planit mësimor. Vlerësimin e bëjnë së bashku mësueset që i kanë dhënë mësim nxënësit.

Në vazhdim janë listuar shembuj se si zbatohet S2-mësimi në shkolla. Nxënësi merr pjesë në mësim të zbatuar në mënyra të ndryshme gjatë shtegut të vijimit të shkollës në bazë të nevojave të tij për mësim.

- 1.) **Mësim i diferencuar në orët e gjuhës amëtare me letërsi**  
Një mësuese jep mësim si sipas synimeve të S1 ashtu dhe të S2 në orë të njëjtë. Nxënësit i ipen detyrat dhe materialet mësimore që i përshtaten nivelit të tij.
- 2.) **Mësimdhënie e njëkohshme**  
S2-mësuesja dhe mësuesja e klasës/S1-mësuesja i dhëjnë mësim tërë grupit njëkohësisht duke marrë parasysh S1 dhe S2 -kurrikulat dhe nivelet e ndryshme të aftësive të nxënësve.
- 3.) **Grup pjesërisht i ndarë**  
Nxënësi një pjesë të mësimin e merr si mësimdhënie të diferencuar me kurrikulë në orët e përbashkëta të gjuhës amëtare me letërsi dhe një pjesë në S2-grupin të veçuar. Në orët e përbashkëta një mësuese merr parasyshë planin mësimor të nxënësve.
- 4.) **S2-grupi i veçuar**  
Nxënësit që mësojnë me S2-planin mësimor marrin mësim të fokusuar atyre në grupin e tyre për shembull gjatë një periudhe apo viti shkollor.
- 5.) **Mësimdhënie e njëkohshme me mbështetje gjuhësore në lëndë të ndryshme shkollore**  
Në orët e lëndëve të ndryshme, përveq mësueses së klasës/lëndës, në mësim mund të merr pjesë edhe S2-mësuesja. Synimet e mësimdhënies atëherë janë si synimet e S2-planit mësimor ashtu dhe synimet e lëndëve shkollore, për shembull aftësitë në tekstet e lëndës shkollore.

## Shumëgjuhësia në shkollë

Sipas ligjit për shkollimin elementar gjuha që përdoret në shkollat fillore është finlandishtja ose (në mësimdhënie në suedishte) suedishtja. Zotërimi i fortë i finlandishtes ose suedishtes është synim i rëndësishëm për tërë mësimin. Në mësimdhënie mund të shfrytëzohen edhe gjuhët tjera. Kur nxënësi mund ta përdorë dhe zhvillojë gjuhën në shtëpi, në shkollë dhe në kohën e lirë, kjo e mbështet si mësimin e gjuhës ashtu dhe mësimin e lëndëve tjera shkollore.

Nxënësit shumëgjuhësorë mund ti përdorin gjuhët që dijnë të mbështesin mësimin në shkollë. Në orët e lëndëve shkollore nxënësit kanë mundësi të kërkojnë informacione, koncepte kyçe të lëndës shkollore nga fjalori në gjuhën që e dijnë apo gjatë orës të bisedojnë për temën në gjuhë tjetër nga finlandishtja. Poashtu edhe prindërit mund të përdorin gjuhën që flitet në shtëpi në bisedë me fëmijën për lëndët shkollore.

Shkathtësinë e komunikimit të rrjedhshëm në dy apo më tepër gjuhë në raste të ndryshme e quajnë shumëgjuhësi funksionale. Në shumëgjuhësinë funksionale gjuhët e ndryshme të nxënësit nuk funksionojnë krejtësisht të ndara, ashtu që një gjuhë është gjuha e shtëpisë dhe tjetra gjuha e shkollës dhe e komunitetit, por secilën gjuhë mund ta përdorë në situata të ndryshme njërën mbi tjetrën. Synimi i mësimdhënjes është të përforcon shumëgjuhësinë funksionale të nxënësve.

Njohtimi me gjuhë të ndryshme dhe krahasimi i tyre zhvillon aftësinë ti njeh dhe mëson gjërat lidhur me gjuhën. Poashtu edhe njohtimi me variacionet e ndryshme të një gjuhe të njëjtë. Duke biseduar për gjuhët dhe verzionet si të barabarta zhduken paragjykimet eventuale për gjuhët/verzionet e ndryshme dhe ndaj folësit të tyre (për shembull anglishtja britaneze apo ajo amerikane ose variacionet e ndryshme e gjuhës së vete amëtare).

Me rëndësi është që nxënësi vazhdimisht të zhvillojë si finlandishten ashtu dhe gjuhët tjera që përdorë në shtëpi dhe në kohën e lirë. Pjesëmarrja në mësimin e gjuhës së vete amëtare ka rëndësi të dukshme. Përdorimi i gjuhës vetëm në shtëpi nuk mjafton që aftësia gjuhësore e nxënësit të zhvillohet në mënyrë të gjithëanshme. Kur nxënësi mëson në gjuhët të cilat i din, i forcohet vetbesimi në aftësitë e veta për të mësuar.

# Roli i prindit në mbështetjen e aftësisë gjuhësore

## Mirëmbajtja e gjuhës së vete

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e gjuhës së vete amëtare është përgjegjësi e prindërve. Në familjet ku prindërit kanë gjuhë të ndryshme amëtare, secili prind mund të përdorë gjuhën e vete amëtare.

Vërejtja e gabimeve apo detyrimi që ta flet një gjuhë të caktuar nuk ndihmon zhvillimin gjuhësor veçanërisht te fëmijët e vegjël, sepse ata ende nuk janë të vetëdësuar në mënyrë të njejtë për përdorimin e gjuhës së vete. Mjafton që i rrituri të përsëritë fjalët e fëmijës në formë të saktë dhe sistematikisht të flet vetëm gjuhën e vete.

Për zhvillimin e gjuhëve nuk ka shumë rëndësi se në cilën gjuhë fëmija për shembull mëson të lexon. Më me rëndësi është që të përvetsohet aftësia gjuhësore dhe ajo të ushtrohet. Është mirë që fëmijëve ti ofrohen stimulime të shumëllojshme (libra, muzikë, video, veprimtari) në gjuhën e vete amëtare. Nëse nuk gjeni materiale në gjuhën e juaj, mund të përdorni edhe materiale në gjuhët tjera (për shembull në gjuhën finlandeze). Kështu fëmijës i ipet edhe mundësia që ti krahason dhe vetëdësohet për gjuhët e ndryshme. Është e natyrshme që gjuhët e ndryshme në familjet shumëgjuhësore përdoren njëkohësisht.

Aftësia në gjuhën që flitet në shtëpi mund të mbetet e ngushtë nëse nuk punohet në zhvillimin e aftësisë gjuhësore. Pjesëmarrja në mësimin e gjuhës së vete amëtare është një mundësi e rëndësishme të zhvillohen në mënyrë të gjithëanshme vokabulari i fjalëve dhe shprehjeve si dhe gjuha.

## Këshilla për mbështetjen e gjuhës së vete amëtare

- Lajmërojeni fëmijën e juaj në mësim të gjuhës së vete amëtare, nëse është e mundur.
- Shfrytëzoni në [Helmet-bibliotekën](#) dhe [Bibliotekën shumëgjuhësore](#) materialet që janë në gjuhën e familjes.
- Shikoni së bashku me fëmijën programe të ndryshme dhe gjatë dhe pas shikimit komentoni së bashku për gjërat që ndodhën.
- Luani lojëra, këndoni, luani dhe këndoni në gjuhën e juaj amëtare. Veçanërisht zhvillojnë gjuhën të luajturit me gjuhën, shakatë dhe barcoletat.
- Bisedoni në gjuhën e juaj amëtare për atë se çfarë ka bërë fëmija kur ishte diku tjetër. Veçanërisht vlenë të bisedohet për shkollën, që fëmija të mëson edhe në gjuhën e vete amëtare fjalët që lidhen me vijimin e shkollës.
- Provoni të gjeni familje ose individ të gjuhës së njejtë dhe të organizoni veprimtari të përbashkët, për shembull takime në bibliotekë. Qyteti Helsinki ofron falas hapsira të ndryshme që mund të rezervohen falas në [Varaamo-faqet](#).
- Në këtë kohë është e mundur të organizohet mësim online për fëmijët, disa shtete ofrojnë mësim të gjuhës online. Shikoni të gjeni mësim të tillë.
- Provoni të gjeni hobi në gjuhën e juaj. Nga komunitetet e gjuhës së njejtë mund të gjeni ndonjë mësues ose trajner për hobi.
- Jepi fëmijës shembull se si shumëgjuhësia është pasuri të cilën mund ta shfrytëzoni në shumë mënyra të ndryshme.

## Mbështetja e aftësisë të finlandishtes

Prindi mund ta mbështetë dhe inkurajon fëmijën në mësimin e finlandishtes pavarësisht nga aftësia e vete në gjuhën finlandeze. Duke vlerësuar dhe duke treguar interesim për mësimin e finlandishtes dhe mësimin në finlandishte prindërit mund të shprehin rëndësinë e kësaj gjëje. Prindërit poashtu mund ta regjistrojnë fëmijën e tyre në veprimtari të kohës së lirë që zhvillon finlandishten. Në këtë kapitull gjeni këshilla për këtë gjë.

Është shumë me rëndësi që prindi me shembullin e vet ti tregojë fëmijës që gjuhën e re vlenë ta zhvillon dhe ta përdorë me trimëri sepse gjuha përforcohet vetëm duke e përdorur atë. Kjo don të thotë se kur mësohet një gjuhë duhet të ushtron duke e përdorur në situata të ndryshme e jo të pret deri sa aftësia gjuhësore të jetë "mjaft e mirë".



Fëmija duhet të inkurajohet të lexon në finlandishte. Leximi zhvillon aftësitë gjuhësore në mënyrë efikase dhe aftësia e leximit të rrjedhshëm është kyçe në mësimin e të gjitha gjerave. Nëse prindi ka brengosje për zhvillimin e aftësive gjuhësore të fëmija, vlenë të kontakton me shkollën dhe të kërkon këshillë.

Për të ushtruar aftësitë e finlandishtes është mirë që fëmija të ketë shoqëri me të cilët si gjuhë të përbashkët e kanë finlandishten. Shoqja/shoku nuk ka nevojë të jetë fëmijë vendas finlandez. Poashtu me u marrë me hobi që mbahet në finlandishte (stërvitje, muzikë, skauting, etj.) mund të ndihmon mësimin e gjuhës.

### **Ofrohen edhe shumë mundësi me u marrë me hobi falas.**

- Mund të kërkonte hobi të ndryshëm në [Apliko për hobi-faqet](#). Këtu gjenden edhe shumë hobi pa pagesë (falas). Disa shoqata, për shembull [Pelastakaa lapset](#), ofrojnë mundësi për hobi.
- Në qytetin Helsinki [qendrat rinore](#) dhe hapsirat e ndryshme të veprimit janë shtuar në Harrastustoiminta-faqet. Në hapsirat e qendrave rinore mund të mirren me hobi ose të kalojnë kohë me fëmijë dhe të rinjtë tjerë në ambient të sigurt.
- [Parku lojrash](#) organizon veprimtari të ndryshme verore dhe drekën falas për nën 16-vjeçarët.
- [Kamping veror](#) është faqe e përbashkët e shoqatave që organizojnë veprimtari kampingu veror fëmijëve dhe të rinjve në Finlandë.
- [Punë vullnetare](#) mund të bëni vet ose me fëmijën.
- Klube sportive pa pagesë për moshë të ndryshme, [Easysport](#)

### **Në televizor (poashtu në internet) gjuhë mund të ushtroni në mënyrë argëtuese**

- [Në Yle Areena \(Lasten Areena, Pikku Kakkonen, Yle Galaxi\)](#)
- Përdorni shërbimet dhe filmat e titruara të kanalit Yle
- Përmes mediave sociale (TikTok, Instagram, Youtube, blogjet) fëmijët mund të njohtohen me përdorimin gjithëanshëm të finlandishtes dhe gjuhëve tjera.
- Me platforma për lojëra online me shokë e shoqe mund të përdoret finlandishtja.

### **Bibliotekat dhe letërsia:**

- [Librat në gjuhën e qartë](#) mund të ndihmojnë ata që mësojnë gjuhën, sepse gjuha në to është më e thjeshtë. Vlenë të lexojnë edhe literaturë tjetër krahas me to. Librin e njëjtë mund ta lexoni edhe në gjuhën amëtare edhe në finlandishte.
- Bibliotekat poashtu ofrojnë [veprimtari të shumëllojshme verore](#).
- Diplomat e ndryshme (për shembull [Finlandishtja si gjuhë e huaj diplomat e leximit](#)) nxisin fëmijët që të lexojnë.

## **Materiale mësimore në internet për mbështetjen e mësimin të gjuhës.**

### **Ushtrime të nivelit fillestar për fëmijë dhe të rinjtë**

- Të flasim-faqet
- [Tregu i groshës](#)
- [Grupi i yjeve - super hero të gjuhës](#) (material që mund të printohet)

### **Ushtrime të nivelit fillestar për të rinjtë dhe të rriturit**

- [finlandishtjanëxhep.eu-faqet](#)
- [Flas finlandisht-faqet](#)
- [Vërtetë finlandisht-faqet](#)
- [Yle finlandishte funksionale](#)
- [Kupto finlandisht-faqet](#)
- [Ushtrime për YKI-testin e gjuhës](#)
- [Kurset online të bibliotekës me kartën e bibliotekës](#)
- [Fipra – Finlandishte praktike-materiali mësimor, edhe për të dëgjuar](#)
- [Kampion i finlandishtes -audiolibrat që dëgjohen](#) (kërkon regjistrimin)
- [Multinet](#)
- [Fraza të finlandishtes](#)

**Helsinki**